



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 791/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht, mori:

V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa nr. 436/16. dt. 05.08.2016 e Universitetit “Haxhi Zeka” për akreditim të programeve të studimit:

- Edukim Artistik në Pikturë, BA Profesional (240 ECTS);
- Edukim Artistik në Këndim, BA Profesional (240 ECTS).

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Universitetit “Haxhi Zeka” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programeve të studimit: Edukim Artistik në Pikturë, BA Profesional (240 ECTS); Edukim Artistik në Këndim, BA Profesional (240 ECTS).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 25 Gusht 2016 ka trajtuar aplikacionin e Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”, bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 02/2013, datë: 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, i cili kërkon që institucioni i arsimit të lartë të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.), apo tre pjesëtarë të stafit akademik me tituj të baras-vlefshëm artistik, në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program të studimit. Pas shqyrtimit të dosjes së stafit akademik, në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.02/2013, datë: 16.01.2013, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet formale për aprovim dhe rrjedhimisht ka refuzuar aprovimin formal të aplikacionit të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” për programet e mësipërme të studimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë